



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura III
Sesioni pranveror

Mbledhja plenare e Kuvendit
P- 121
Prishtinë, më 22 dhe 26 korrik 2010

PROCES\VERBAL

**I MBLEDHJES PLENARE TË KUVENDIT TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS, TË
MBAJTUR MË 22 DHE 26 KORRIK 2010**

Në fillim mbledhjen e kryesoi **Xhavit Haliti**, anëtar i Kryesisë së Kuvendit.

Kryesuesi i njoftoi deputetët se Kryesia e Kuvendit, në marrëveshje me kryetarët e grupeve parlamentare, ka përgatitur dhe Kuvendit ia ka paraqitur rendin e ditës për mbledhjen e sotme plenare.

Kuvendi i zhvilloi punimet me këtë

Rend dite

1. Koha për deklarime jashtë rendit të ditës,
2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mëparshme plenare,
3. Koha për pyetje parlamentare,
4. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për gjykatat,
5. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për ekzekutimin e sanksioneve penale,
6. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për Avokatin e Popullit,
7. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për grevat,
8. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për miniera dhe minerale,
9. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për Inspektoratin e Tregut dhe mbikëqyrjen inspektuese,

10. Shqyrtimi i Raportit të punës të Avokatit të Popullit, për vitin 2009,
11. Shqyrtimi i Raportit vjetor të Autoritetit Rregullativ të Telekomunikacionit për vitin 2009,
12. Shqyrtimi i Raportit vjetor të Institutit Gjyqësorë të Kosovës, për vitin 2009,
13. Shqyrtimi i Raportit të Auditimit për pasqyrat financiare të kompanisë së ujësjellësit rajonal "Prishtina", për vitin 2009,
14. Shqyrtimi i Raportit të Auditimit për pasqyrat financiare të institucionit të Avokatit të Popullit, për vitin 2009,
15. Shqyrtimi i Raportit të punës së Komisionit Qendror të Zgjedhjeve , për vitin 2009,
16. Shqyrtimi i rekomandimit të Komisionit për Programin Kombëtar të Shkencës,
17. Shqyrtimi i rekomandimit të Komisionit për Mbikëqyrjen e Financave Publike lidhur me pasqyrat e audituara të Trustit të Kursimeve Pensionale, për vitin 2009,
18. Shqyrtimi i Propozim-vendimit të Qeverisë së Kosovës për emërimin e kryesuesit dhe anëtarëve të Bordit të Agjencisë së Privatizimit.

1. Koha për deklarime jashtë rendit të ditës

Deklarime jashtë rendit të ditës paraqitën këta deputetë: Suzan Novoberdaliu, Ahmet Isufi, Nait Hasani, Myrvete Pantina, Besa Gaxherri, Rexhep Hoti, Melihate Tërmmkollli, Nurishahe Hulaj, Driton Tali dhe Ismajl Kurteshi, të cilat janë dhënë në transkript.

2. Miratimi i Procesverbaleve të mbledhjeve plenare të mëparshme

Procesverbalet e mbledhjeve plenare, të mbajtura më 8 dhe 12 korrik 2010, u miratuan pa vërejtje.

3. Koha për pyetje parlamentare

Deputeti **Ismajl Kurteshi**, parashtroi pyetje për ministrin, Nenad Rashiç, lidhur me numrin e të punësuarve në ndërmarrjet e privatizuara pas luftës.

Ministri **Nenad Rashiç**, iu përgjigj pyetjes së deputetit Ismajl Kurteshi.

Deputetja **Nurishahe Hulaj**, parashtroi pyetje për ministrin Blerand Stavileci, në lidhje me atë se a ka Ministria që ai drejton strategji të veçantë për mbrojtjen e tokave bujqësore.

Ministri **Blerand Stavileci**, iu përgjigj pyetjes së deputetes Nurishahe Hulaj.

Deputeti **Driton Tali** lexoi pyetjen për ministrin, Ahmet Shala, lidhur me vlerësimin e aseteve të PTK-së nga këshilltarët e transaksionit dhe çmimin e tyre.

Ministri Shala nuk ishte i pranishëm në seancë.

Deputeti **Driton Tali** lexoi pyetjen për ministrin, Ahmet Shala, lidhur me planet e Qeverisë për të vendosur kontroll ndaj veprimtarisë së bastoreve sportive nga ana e Administratës Tatimore të Kosovës.

Ministri Shala nuk ishte i pranishëm në seancë.

4. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për gjykatat

Kryesuesi i njoftoi deputetët me procedurat e shqyrtimit të Projektligjit për gjykatat, si dhe me raportet dhe rekomandimet e komisioneve të përhershme dhe të Komisionit funksional-raportues.

Raportin e Komisionit të Komisionit për Legjislacion dhe Gjyqësi, si komision raportues e arsyetoi kryetari i këtij komisioni, Bahri Hyseni.

Kryesuesi i hodhi në votim amendamentet e propozuara, një nga një.

Kuvendi miratoi këto amendamente: 1, 2, 3, 4, 5,, 6, 7, 8, 9, 10,. 11, 12, 13, 14, 15, 156, 17, 18, 19, 20, 21, 22, 23, 24, 25, 26, 27 (a), 28, 31, 32, 33, 34, 36, 37, 38 (a), 39 (a), 40 (a) dhe 41.

Kuvendi nuk miratoi amendamentet: 29, 30 dhe 35.

Pastaj, kryesuesi e hodhi në votim Projektligjin me amendamentet e miratuara në tërësi. Rezultati i votimit ishte si vijon:

- Për67
- Kundër..... 0
- Abstenime..... 8.

Kryesuesi konstatoi se Kuvendi, me shumicë votash, miratoi Ligjin për gjykatat.

5. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për ekzekutimin e sanksioneve penale

Kryetari i njoftoi deputetët me procedurat e shqyrtimit të Projektligjit për ekzekutimin e sanksioneve penale, si dhe me raportet dhe rekomandimet e komisioneve të përhershme dhe të Komisionit funksional-raportues.

Raportin e Komisionit të Komisionit për Legjislacion dhe Gjyqësi, si komision raportues e arsyetoi kryetari i këtij komisioni, Bahri Hyseni.

Kryetari i hodhi në votim amendamentet e propozuara, një nga një.

Kuvendi miratoi këto amendamente: 1, 2, 3, 4, 5,, 6, 7, 8, 9, 10, 11, 12, 13, 14, 15, 156, 17, 18, 19, 20, 21, 22, 23, 24, 25, 26, 27, 28, 29, 30, 31, 32, 33, 34, 3, 36, 37, 38, 39 dhe 40.

Pastaj, kryetari e hodhi në votim Projektligjin me amendamentet e miratuara në tërësi. Rezultati i votimit ishte si vijon:

- Për70
- Kundër..... 0
- Abstenime..... 2.

Kryetari konstatoi se Kuvendi, me shumicë votash, miratoi Ligjin për ekzekutimin e sanksioneve penale.

6. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për Avokatin e Popullit

Kryesuesi i njoftoi deputetët me procedurat e shqyrtimit të Projektligjit për Avokatin e Popullit, si dhe me raportet dhe rekomandimet e komisioneve të përhershme dhe të Komisionit funksional-raportues.

Raportin e Komisionit për Legjislacion dhe Gjyqësi, si komision raportues e arsyetoi kryetari i këtij komisioni, Bahri Hyseni.

Lidhur me amendamentet e propozuara diskutuan edhe deputetët Hydajet Hyseni dhe Gani Koci.

Kryesuesi i hodhi në votim amendamentet e propozuara, një nga një.

Kuvendi miratoi këto amendamente: 1, 2, 4, 5, 7, 8 (a), 9 (a), 10, 11 (a), 12, 13, 14, 15, 156, 17 (a), 18, 19, 20, 21, 22, 23 (a), 24, 25, 26, 27, 28 dhe 31.

Kuvendi nuk miratoi amendamentet: 3 dhe 6.

Pastaj, kryesuesi e hodhi në votim Projektligjin me amendamentet e miratuara në tërësi. Rezultati i votimit ishte si vijon:

- Për57
- Kundër..... 0
- Abstenime..... 3.

Kryesuesi konstatoi se Kuvendi, me shumicë votash, miratoi Ligjin për Avokatin e Popullit.

7. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për grevat

Kryesuesi i njoftoi deputetët me procedurat e shqyrtimit të Projektligjit për grevat, si dhe me raportet dhe rekomandimet e komisioneve të përhershme dhe të Komisionit funksional-raportues.

Raportin e Komisionit për Punë, Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale, si komision raportues e arsyetoi deputetja Teutë Hadri.

Kryesuesi i hodhi në votim amendamentet e propozuara, një nga një.

Kuvendi miratoi këto amendamente: 2, 4, 5, 7, **8 (i riformular)** dhe 9.

Komisioni Funksional e tërhoqi amendamentin 1.

Pastaj, kryesuesi e hodhi në votim Projektligjin me amendamentet e miratuara në tërësi. Rezultati i votimit ishte si vijon:

- Për57
- Kundër..... 0
- Abstenime..... 3.

Kryesuesi konstatoi se Kuvendi, me shumicë votash, miratoi Ligjin për grevat.

8. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për miniera dhe minerale

Kryesuesi i njoftoi deputetët me procedurat e shqyrtimit të Projektligjit për grevat, si dhe me raportet dhe rekomandimet e komisioneve të përhershme dhe të Komisionit funksional-raportues.

Raportin e Komisionit për Ekonomi, Tregti, Industri, Energjetikë dhe Transport, si komision raportues e arsyetoi kryetarja e këtij komisioni, Myzejene Selmani.

Kryetari i Komisionit për Legjislacion dhe Gjyqësi, Bahri Hyseni pati vërejtje në disa amendamente të propozuara nga komisioni funksional.

Lidhur me amendamente të propozuara nga komisioni funksional diskutuan edhe këta deputetë: Gani Koci, Sala Berisha-Shala, Besa Gaxherri, Driton Tali dhe Ethem Çeku.

Kryesuesi në orën 14:00 dha pauzë dreke.

Gjatë kohës së pauzës, Gjykata Ndërkombëtare e Drejtësisë paraqiti opinionin lidhur me ligjshmërinë e shpalljes së pavarësisë së Kosovës.

Pas pauzës, kryesuesi, në emër të Kuvendit të Republikës së Kosovës, përshëndeti opinionin e Gjykatës Ndërkombëtare e Drejtësisë, me të cilin ishte konstatuar se shpallja e pavarësisë së Kosovës, më 17 shkurt 2008, nuk ka qenë në kundërshtim me të Drejtën Ndërkombëtare, nuk ka qenë në kundërshtim me Rezolutën e KS të OKB-së 1244 dhe nuk ka qenë në kundërshtim me Kornizën Kushtetuese të Kosovës.

Kryesuesi, me pëlqimin e grupeve parlamentare, mbylli punimet e mbledhjes së sotme, për t'i vazhduar punimet të hënën, më 26 korrik 2010.

Vazhdimi i mbledhjes plenare, E hënë, 26 korrik 2010

Mbledhjen e drejtoi **Jakup Krasniqi**, kryetar i Kuvendit, kurse i ndihmoi **Xhavit Haliti**, anëtar i Kryesisë së Kuvendit.

Kryetari konstatoi se në sallë janë të pranishëm 53 deputetë dhe i deklaroi të hapur punimet e seancës.

Kuvendi i vazhdoi punimet me pikën 8 të rendit të ditës - **Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për miniera dhe minerale.**

Në emër të komisionit funksional për Ekonomi, Tregti, Industri, Energjetikë, Transport dhe Telekomunikacion, **Myzejene Selmani** paraqiti sqarime shtesë në lidhje me amendamentet e propozuara, si dhe Bahri Hyseni në emër të Komisionit për Legjislacion dhe Gjyqësi.

Kryesuesi i hodhi në votim një nga një, amendamentet e Komisionit funksional.

Kuvendi miratoi këto amendamente: 1, 2, 3, 4, 6, 7, 8, 9, 10, 11, 12, 13, 14, 15, 16, 17, 18, 19, 20, 21, 22, 23, 24, 25, 26, 27, 28, 29, 30, 31, 32, 33, 34, 35, 36, 37, 38, 39, 40, 41, 42, 43, 44, 45, 46, 47, 48, 49, 50 a), 51, 52, 54, 55, 56, 57, 58, 59, 61, 62, 63, 64, 65, 66, 67, 68, 69, 70, 71, 72, 73 dhe 74.

Kryesuesi në vazhdim hodhi në votim tekstin e Projektligjit për miniera dhe minerale, në tërësi, me amendamentet e miratuara. Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për----- 58
Kundër-----1,
Abstenime----- 6.

Kryesuesi konstatoi se Kuvendi miratoi Ligjin për miniera dhe minerale.

9. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për Inspektoratin e Tregut dhe mbikëqyrjen inspektuese

Kryesuesi njoftoi Kuvendin se Komisioni funksional për Ekonomi, Tregti, Industri, Energjetikë, Transport dhe Telekomunikacion, e ka shqyrtuar Projektligjin për Inspektoratin e Tregut dhe mbikëqyrjen inspektuese dhe Kuvendit i ka rekomanduar miratimin e tij me amendamentet e propozuara.

Kryesuesi i hodhi në votim një nga një, amendamentet e Komisionit funksional.

Kuvendi miratoi amendamentet : 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8, 9, 10, 11, 12, 13, 14, 15, 16, 17, 18, 19, 20, dhe amendamentin nr. 21, të propozuar në Projektligjin për Inspektoratin e Tregut dhe mbikëqyrjen inspektuese.

Kryesuesi në vazhdim hodhi në votim tekstin e projektligjit në tërësi, me amendamentin e miratuar. Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për-----53,
Kundër-----0,
Abstenime-----4.

Kryesuesi konstatoi se Kuvendi miratoi Ligjin për Inspektoratin e Tregut dhe mbikëqyrjen inspektuese.

10. Shqyrtimi i Raportit të punës së Avokatit të Popullit, për vitin 2009

Kryesuesi, në fillim të shqyrtimit kësaj pike tha se Komisioni FunkSIONAL për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore, Persona të Pagjetur dhe Peticione, në pajtim me dispozitat e Rregullores së Kuvendit, ka shqyrtuar Raportin e punës së Avokatit të Popullit, për vitin 2009 dhe Kuvendit i ka rekomanduar për miratim.

Sami Kurteshi, në fillim të fjalës falënderoi Kuvendin për ftesën e bërë për t'u drejtuar deputetëve të Kuvendit. Raporti paraqet një analizë gjithëpërfshirëse për të drejtat e njeriut në Republikën e Kosovës, për periudhën kohore të cilën e përshkon, tha ai.

Në vazhdim konstatoi se shpallja e pavarësisë së Kosovës dhe miratimi i Kushtetutës së Republikës së Kosovës, padyshim që janë ngjarje të shënuara edhe në fushën e mbrojtjes së të drejtave dhe lirive të njeriut, tek ne.

Më tutje, ai tha se Raporti të cilin sot po e diskuton Kuvendi, është i nënti me radhë dhe përfshin periudhën kalendarike afër një vit e gjysmë, ndërsa përbëhet prej 8 kapitujve, esenca e raportit qëndron në kapitullin e tretë, kurse kapitulli i katërt përmban rekomandimet e Avokatit të Popullit, për përmirësimin e mëtejshëm të drejtave të njeriut në vendin tonë. Raporti i këtij viti ka ngjashmëri me raporte paraprake, por dallon për nga aspekti konceptual, theksoi ai.

Ai më tej tha se edhe pse Republika e Kosovës ende nuk është anëtare e Këshillit të Evropës, përmbajtja e Raportit përkon me kriteret e vendosura nga ky organ, dhe se marrja e njëanshme e mbrojtjes së të drejtave dhe lirive të njeriut janë detyra shtesë dhe jo të lehta. Nga 1300 raste të paraqitura të ankesave në adresë të Avokatit të Popullit, numri më i madh i ankuesve ka të bëjë me gjyqësorin, pastaj Qeverinë, komunat, Agjencinë e Privatizimit etj, konstatoi ai.

Për institucionin e Avokatit të Popullit, brengosës është fakti i humbjes së besimit të qytetarëve në sistemin e drejtësisë dhe shkelja e të drejtave të njeriut nga institucionet publike, tha në fund të fjalës së tij Sami Kurteshi.

Kryesuesi hapi debatin për shqyrtimin e Raportit të punës së Avokatit të Popullit, për vitin 2009.

Opinione, vërejtje dhe sugjerime lidhur me këtë raport dhanë: në emër të Komisioni FunkSIONAL për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore, Persona të Pagjetur dhe Peticione, dhe në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, Fatmir Rexhepi, në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së, Ramë Buja, në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, Zylfije Hundozi, në emër të Grupit Parlamentar të AKR-së, Ibrahim Makolli, në emër të Grupit Parlamentar të LDD-së, Drita Maliqi, në emër të Grupit Parlamentar "7+" , Shpresa Murati, ndërsa në emër të Grupit Parlamentar për Integrim, Vezira Emrush, si dhe deputetët: Sanije Aliaj, Gjynaze Syla, Arsim Bajrami, Riza Smaka, Xhavit Haliti, Ibrahim Selmanaj, Bajram Kosumi, Gani Buçinca dhe Eqrem Kryeziu , që janë dhënë në transkript.

Pas këtyre diskutimeve, kryetari hodhi në votim miratimin e Raportit të punës së Avokatit të Popullit, për vitin 2009.

Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për-----74,
Kundër-----0,
Abstenime-----0.

Kryesuesi konstatoi se Kuvendi e miratoi Raportin punës së Avokatit të Popullit për vitin 2009.

11. Shqyrtimi i Raportit të Autoritetit Rregullativ të Telekomunikacionit, për vitin 2009

Kryesuesi tha se Komisioni funksional për Ekonomi, Tregti, Industri, Energjetikë, Transport dhe Telekomunikacion, në pajtim me dispozitat e Rregullores së Kuvendit, ka shqyrtuar Raportin të punës së Autoritetit Rregullativ të Telekomunikacionit, për vitin 2009 dhe Kuvendit i ka paraqitur Raportin me rekomandime, për miratim.

Kryesuesi hapi debatin për shqyrtimin e Raportit të punës së Autoritetit Rregullativ të Telekomunikacionit, për vitin 2009.

Deputetja **Myzejene Selmani** në emër të Komisionit funksional, paraqiti Raportin me rekomandime.

Opinione, vërejtje dhe sugjerime lidhur me këtë raport dhanë: në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së, Ramë Buja, në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, Fatmir Rexhepi, në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, Ethem Çeku, në emër të Grupit Parlamentar të AKR-së, Ibrahim Makolli, në emër të Grupit Parlamentar të LDD-së, Qamile Morina, në emër të Grupit Parlamentar “7+”, Zylfi Merxha, ndërsa në emër të Grupit Parlamentar për Integrim, Vezira Emrush, si dhe deputetët: Sanije Aliaj, Zef Morina, Gjylnaze Sylja, Myzejene Selmani, Armend Zemaj, Abdyl Ymeri, Riza Smaka, që janë dhënë në transkript.

Pas këtyre diskutimeve, kryetari hodhi në votim miratimin e Raportit të punës së Autoritetit Rregullativ të Telekomunikacionit, për vitin 2009

Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për----- 30,
Kundër----- 1,
Abstenime----- 3.

Kryetari konstatoi se Kuvendi me shumicë votash e miratoi Raportin e punës së Autoritetit Rregullativ të Telekomunikacionit, për vitin 2009, me rekomandimet e Komisionit funksional.

12. Shqyrtimi i Raportit vjetor të Institutit Gjyqësor të Kosovës, për vitin 2009

Kryesuesi tha se Komisioni funksional për Legjislacion dhe Gjyqësi, në pajtim me dispozitat e Rregullores së Kuvendit, ka shqyrtuar Raportin vjetor të Institutit Gjyqësor të Kosovës, për vitin 2009 dhe Kuvendit i ka rekomanduar për miratim.

Opinione, vërejtje dhe sugjerime lidhur me këtë raport dhanë këta deputetë: në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së, Bahri Hyseni, në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, Armend Zemaj, në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, Bajram Kosumi, në emër të Grupit Parlamentar të AKR-së, Riza Smaka, në emër të Grupit Parlamentar të LDD-së, Gani Geci, në emër të Grupit Parlamentar “7+”, Sadik Idriz, në emër të Grupit

Parlamentar SLS, Mursel Halili, ndërsa në emër të Grupit Parlamentar për Integritet, Vezira Emrush, si dhe deputetët: Driton Tali dhe Naim Rustemi, që janë dhënë në transkript.

Pas këtyre diskutimeve, kryesuesi e hodhi në votim miratimin e këtij Raporti. Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për----- 50,
Kundër----- 5,
Abstenime-----10.

Kryesuesi konstatoi se Kuvendi miratoi Raportin vjetor të Institutit Gjyqësor të Kosovës, për vitin 2009.

13. Shqyrtimi i Raportit të auditimit për pasqyrat financiare të kompanisë ujësjellësit rajonal "Prishtina", për vitin 2009

Kryesuesi tha se Komisioni Funkcional për Mbikëqyrjen e Financave Publike, në pajtim me dispozitat e Rregullores së Kuvendit, ka shqyrtuar Raportin e auditimit për pasqyrat financiare të kompanisë ujësjellësit rajonal "Prishtina", për vitin 2009, dhe Kuvendit i ka paraqitur Raportin me rekomandime, për miratim.

Opinione, vërejtje dhe sugjerime lidhur me këtë raport dhanë këta deputetë: në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së, Safete Hadergjonaj, në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, Myrvete Pantina, në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, Xhevdet Neziraj, në emër të Grupit Parlamentar të AKR-së, Riza Smaka, në emër të Grupit Parlamentar të LDD-së, Synavere Rysha, në emër të Grupit Parlamentar "7+", Zylfi Merxha, në emër të Grupit Parlamentar SLS, Mursel Halili, ndërsa në emër të Grupit Parlamentar për Integritet, Vezira Emrush, si dhe deputeti, Riza Smaka, që janë dhënë në transkript.

Pas këtyre diskutimeve, kryesuesi e hodhi në votim miratimin e këtij raporti. Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për-----47,
Kundër----- 6,
Abstenime----- 8.

Kryesuesi konstatoi se Kuvendi miratoi Raportin e auditimit për pasqyrat financiare të kompanisë së ujësjellësit rajonal "Prishtina", për vitin 2009, me rekomandimet e Komisionit funksional.

14. Shqyrtimi i Raportit të Auditimit për pasqyrat financiare të institucionit të Avokatit të Popullit, për vitin 2009

Kryesuesi tha se Komisioni Funkcional për Mbikëqyrjen e Financave Publike, në pajtim me dispozitat e Rregullores së Kuvendit, ka shqyrtuar Raportin e Auditimit për pasqyrat financiare të institucionit të Avokatit të Popullit, për vitin 2009, dhe Kuvendit i ka paraqitur Raportin me rekomandime, për miratim.

Opinione, vërejtje dhe sugjerime lidhur me këtë raport dhanë këta deputetë: në emër të Komisionit funksional dhe në emër të Grupit Parlamentar të LDD-së, Synavere Rysha, në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së, Ramë Buja, në emër të Grupit Parlamentar të

LDK-së, Armend Zemaj, në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, Xhevdet Neziraj, në emër të Grupit Parlamentar të AKR-së, Ibrahim Gashi, në emër të Grupit Parlamentar “7+”, Zylfi Merxha, në emër të Grupit Parlamentar SLS, Mursel Halili, ndërsa në emër të Grupit Parlamentar për Integritet, Vezira Emrush, si dhe deputetja Gjylnaze Sylaj, që janë dhënë në transkript.

Pas këtyre diskutimeve, kryesuesi e hodhi në votim miratimin e këtij raporti.
Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për-----62 ,
Kundër-----0,
Abstenime-----2.

Kryesuesi konstatoi se Kuvendi miratoi Raportin e Auditimit për pasqyrat financiare të institucionit të Avokatit të Popullit, për vitin 2009, me rekomandimet e Komisionit funksional.

15. Shqyrtimi i Raportit të punës së Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, për vitin 2009

Kryesuesi tha se Komisioni Funksional për Legjislacion dhe Gjyqësi, në pajtim me dispozitat e Rregullores së Kuvendit, ka shqyrtuar Raportin e punës së Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, për vitin 2009, dhe Kuvendit i ka paraqitur raportin me rekomandime, për miratim.

Opinione, vërejtje dhe sugjerime lidhur me këtë raport dhanë këta deputetë: në emër të Komisionit funksional, Bahri Hyseni, në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së, Ramë Buja, në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, Armend Zemaj, në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, Ardian Gjini, në emër të Grupit Parlamentar të AKR-së, Ibrahim Makolli, në emër të Grupit Parlamentar të LDD-së, Gani Geci, në emër të Grupit Parlamentar “7+”, Xhezair Murati, në emër të Grupit Parlamentar SLS, Mursel Halili, ndërsa në emër të Grupit Parlamentar për Integritet, Branislav Grbiç, si dhe deputetët: Emrush Xhemajli, Bajram Kosumi, Qamile Morina, Driton Tali dhe Armend Zemaj, që janë dhënë në transkript.

Pas këtyre diskutimeve, kryesuesi e hodhi në votim miratimin e këtij raporti.
Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për----- 38,
Kundër----- 30,
Abstenime----- - 3.

Kryesuesi konstatoi se Kuvendi miratoi raportin vjetor të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, për vitin 2009, me rekomandimet e Komisionit funksional.

16. Shqyrtimi i Rekomandimit të Komisionit funksional për Programin Kombëtar të Shkencës

Kryesuesi tha se Komisioni Funksional për Arsim, Shkencë dhe Teknologji, Kulturë, Rini e Sporte, në pajtim me dispozitat e Rregullores së Kuvendit, ka shqyrtuar Programin Kombëtar të Shkencës, dhe Kuvendit i ka paraqitur raportin, për miratim.

Opinione, vërejtje dhe sugjerime lidhur me këtë raport dhanë këta deputetë: në emër të Komisionit funksional, Mark Krasniqi, në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së, Drita Kadriu, në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, Adem Hajdaraj, në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, Donika Kadaj-Bujupi, në emër të Grupit Parlamentar të AKR-së, Haset Cakolli, në emër të Grupit Parlamentar “7+”, Sadik Idriz, ndërsa në emër të Grupit Parlamentar për Integritet, Branislav Grbiç, si dhe deputetët: Ibrahim Gashi, Driton Tali, Gani Buçinca, Naim Rustemi, Bujar Dugolli, Hajdin Abazi, Berim Ramosaj, Riza Smaka, dhe ministri Enver Hoxhaj, që janë dhënë në transkript.

Pas këtyre diskutimeve, kryesuesi e hodhi në votim miratimin e këtij programi. Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për----- 58 ,
Kundër----- 0,
Abstenime----- 3.

Kryesuesi konstatoi se Kuvendi miratoi Programin Kombëtar të Shkencës, për periudhën pesëvjeçare.

17. Shqyrtimi i Rekomandimit të Komisionit për Mbikëqyrjen e Financave Publike, lidhur me pasqyrat e audituara të Trustit të Kursimeve Pensionale, për vitin 2009

Kryesuesi tha se Komisioni Funksional për Mbikëqyrjen e Financave Publike, në pajtim me dispozitat e Rregullores së Kuvendit, ka shqyrtuar pasqyrat e audituara të Trustit të Kursimeve Pensionale, për vitin 2009, dhe Kuvendit i ka paraqitur raportin me rekomandime, për miratim.

Opinione, vërejtje dhe sugjerime lidhur me këtë raport dhanë këta deputetë: në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së, Ramë Buja, në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, Armend Zemaj, në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, Xhevdet Neziraj, në emër të Grupit Parlamentar të AKR-së, Riza Smaka, në emër të Grupit Parlamentar të LDD-së, Synavere Rysha, në emër të Grupit Parlamentar “7+”, Sadik Idriz, ndërsa në emër të Grupit Parlamentar për Integritet, Branislav Grbiç, si dhe deputetët: Gjylnaze Sylja dhe Myrvete Pantina, që janë dhënë në transkript.

Pas këtyre diskutimeve, kryesuesi e hodhi në votim miratimin e këtij raporti. Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për----- 37,
Kundër----- 18,
Abstenime----- 3.

Kryesuesi konstatoi se Kuvendi miratoi pasqyrat e audituara të Trustit të Kursimeve Pensionale, për vitin 2009, me rekomandimet e Komisionit funksional.

18. Shqyrtimi i Propozim-vendimit të Qeverisë së Republikës së Kosovës për emërimin e kryesuesit dhe anëtarëve të Bordit të Agjencisë së Privatizimit

Kryesuesi tha se komisionet parlamentare, në pajtim me dispozitat e Rregullores së Kuvendit, kanë shqyrtuar Propozim-vendimin e Qeverisë së Republikës së Kosovës për emërimin e kryesuesit dhe anëtarëve të bordit të Agjencisë së Privatizimit dhe Kuvendit i ka paraqitur raportin me rekomandime, për miratim.

Opinione, vërejtje dhe sugjerime lidhur me këtë propozim-vendim dhanë këta deputetë: në emër të Komisionit për Buxhet dhe Financa dhe në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së, Gani Koci, në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, Ardian Gjini, në emër të Grupit Parlamentar të AKR-së, Ibrahim Makolli, në emër të Grupit Parlamentar të LDD-së, Besa Gaxherri, në emër të Grupit Parlamentar “7+”, Xhezair Murati, në emër të Grupit Parlamentar SLS, Mursel Halili, ndërsa në emër të Grupit Parlamentar për Integritet, Vladimir Todoroviç, si dhe deputetët: Driton Tali dhe Naim Rrustemi, që janë dhënë në transkript.

Pas këtyre diskutimeve, kryesuesi e hodhi në votim miratimin e këtij propozim-vendimi. Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për----- 36,
Kundër----- 22,
Abstenime----- 3.

Kryesuesi konstatoi se Kuvendi, mori këtë

V E N D I M

Për emërimin e kryesuesit dhe anëtarëve të bordit të Agjencisë së Privatizimit

I. Kryesues dhe anëtarë të bordit të Agjencisë së Privatizimit emërohen:

1. Dino Asanaj, kryesues,
2. Sllobodan Petroviç, anëtar,
3. Haxhi Arifi, anëtar, dhe
4. Bahri Shabani, anëtar.

II. Mandati i të emëruarve nga pika **I.** e këtij vendimi zgjatë dy (2) vjet.

Në këtë mbledhje plenare, deputetëve të Kuvendit iu drejtua me një fjalë rasti kryeministri i Republikës së Kosovës, zoti Hashim Thaçi, me rastin e nxjerrjes së mendimit këshillëdhënës së Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë, në lidhje me legjitimitetin e shpalljes së pavarësisë së Republikës së Kosovës.

Hashim Thaçi, duke shprehur qëndrimin e Qeverisë së Republikës së Kosovës, tha se qytetarët e Kosovës dhe institucionet e saj gjithnjë kanë pasur besim në ligjshmërinë e

procesit të pavarësimit të Kosovës dhe se mendimi këshillëdhënës i Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë, vetëm sa e ka vulosur pavarësinë e Kosovës në arenën ndërkombëtare.

Në vazhdim theksoi se mendimi këshillëdhënës i Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë, paraqet një ofertë historike për Kosovën dhe rajonin. Ky mendim këshillëdhënës nuk është i drejtuar ndaj askujt dhe ai e forcon legjitimitetin tonë për liri dhe shtet bërje, dhe dëshmon se e drejta jonë dhe përpjekjet tona për liri dhe pavarësi, kanë qenë në përputhje të plotë me të drejtën ndërkombëtare.

Më tutje theksoi se ky mendim këshillëdhënës i Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë, respekton angazhimet tona për shtet demokratik dhe paraqet kontribut për paqe, zhvillim dhe demokraci kudo në botë, me zotimin e sigurt se opinioni i GJND-së ka hapur perspektiva të sigurta për qytetarët tanë, për liberalizimin e vizave për qytetarët e Republikës së Kosovës, në një të ardhme, dhe për integrimin e Kosovës në strukturat euroatlantike.

Më tej, kryeministri Thaçi tha se një përkrahje e plotë për shtetin e Kosovës, për të gjitha këto procese integruese, i është rikonfirmuar edhe me rastin e vizitës së sapo përfunduar zyrtare në SHBA, nga nënpresidenti Joe Biden.

Në fund të fjalës së tij ai ftoi të gjitha shtetet të cilat ende nuk e kanë njohur pavarësinë e Kosovës që sa më parë ta bëjnë këtë.

Kryesuesi e deklaroi të mbyllur seancën në orën 18:45 minuta.

Kryetari i Kuvendit
Jakup KRASNIQI

Përgatiti: Divizioni për Çështje Plenare dhe Procedurale